



Punim udhëzues

TË DHËNAT E HAPURA QEVERITARE: ÇELËS PËR TRANSPARENÇË, LLOGARIDHËNIE DHE SHOQËRI AKTIVE

Hyrja

Zhvillimi i hovshëm i Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK-ut) dhe përdorimi i gjerë i internetit ka lehtësuar qasshmërinë e publikut në informacion. Veçanërisht portalet e institucioneve publike janë duke u bërë qendra e informacionit sa i përket veprimtarisë së sektorit publik. Duke parë hapat e fundit të zhvillimit të teknologjisë së informacionit, institucionet qeveritare janë duke ngritur kapacitet e shërbimeve online përmes zhvillimit të platformës e-qeveria. Në këtë mënyrë promovohet transparenca dhe ngritët pjesëmarrja publike në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes. Gjithashtu, institucionet qeveritare të vendeve të ndryshme vazhdimisht janë duke publikuar informacione dhe duke hapur të dhëna që janë me rëndësi për publikun e gjerë.

Termi të Dhënat e Hapura Qeveritare (OGD – 'Open Government Data') është duke u përdorur gjerësisht, duke u munduar të mbërthej fenomenin në rritje të të dhënave të hapura. Si term është relativisht i ri, i cili më saktësisht u popullarizua gjatë vitit 2008¹. Fillimisht, OGD-ja është promovuar nga një grup

liderësh dhe aktivistësh të cilët në dhjetor të 2007-tës u takuan të diskutojnë dhe definojnë një koncept për të dhënat e hapura publike.² Pas kësaj, u pranua dhe u vlerësua shumë rëndësia e të dhënave publike, potenciali i internetit dhe vlera e qasshmërisë së të dhënave publike përmes internetit. Koncepti i lirisë së qasjes në informacion ka evoluar duke lëvizur drejt iniciativave proaktive të institucioneve publike për hapjen e të dhënave publike. Ky është bërë objektiv dhe angazhim politik për shumë vende në botë.³

Megjithëse rëndësia e hapjes së të dhënave publike është në ngritje gjithnjë e më shumë në gjithë botën; e sidomos në vendet e zhvilluara, Kosova akoma konsiderohet si vend mjaft i mbyllur në këtë aspekt. Arsye kryesore është se në Kosovë akoma praktikohet forma pasive e marrjes së informacionit përmes kërkesave individuale nëpër institucionet përkatëse. I gjithë procesi është mjaft i mundimshëm, dhe ka raste kur kërkesa nuk merret fare parasysh.

1 http://www.opendataforum.info/files/OECD_Barbara_Ubalde.pdf

2 <https://www.data.gov/blog/open-data-history>

3 http://www.opendataforum.info/files/OECD_Barbara_Ubalde.pdf

Vlen të theksohet se gjatë viteve të fundit, Kosova ka bërë disa përmisime të vogla. Disponueshmeria e të dhënave biznesore apo të dhëna të institucioneve politike, siç janë: Organi Shqyrtues i Prokurimit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik është ngritur. Mirëpo, të dhënat janë të publikuara në versionet PDF ose Word, e jo në formate të hapura. Po ashtu vërehen ndryshime dhe përmisime në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike; për shembull, afati i fundit për përgjigje institucionale tani është shkurtuar në shtatë ditë në krahasim me 15 ditë siç parashihte ligji i kaluar. Dhe e fundit, portali i të dhënave të hapura është një lëvizje e mundshme nga institucionet qeveritare relevante.

Marrë parasysh përmbajtjen, ky punim udhëzues tenton të: (i) japë një informacion më të detajuar mbi konceptin e OGD-së dhe benefitet që sjell ajo; (ii) japë një përshkrim të gjendjes së tanishme të Kosovës në lidhje me qasjen në informacion; (iii) sjell një rast suksesi nga rajoni; dhe (iv) japë rekomandime.

1. Kuptimi i të dhënave të hapura qeveritare (OGD)

Të Dhënat e Hapura Qeveritare (OGD) janë të dhëna të prodhuara ose poseduara nga qeveria dhe institucione qeveritare si dhe të publikuara në platforma online.⁴ Platforma e OGD-së mundëson që qeveria dhe organizatat e tjera të hapin të dhënat e tyre, në mënyrë që ato të jenë të gatshme pa pagesë dhe lehtë të qasshme online. Për të qenë më të saktë, të dhënat të cilat konsiderohen të jenë të hapura duhet të plotësojnë këto kushte; ato duhet të jenë të kompletuara, primare, azhuruara, strukturuar, qasshme, me format të përpunueshëm kompjuterik, jo-diskriminuese, pa pronësi, dhe pa ndonjë formë të licencimit apo patentimit.

⁴ <http://opengovernmentdata.org/#sthash.q3iFN8iA.dpuf>

Pse të Hapen të Dhënat Qeveritare?

Sipas Direktivës për Qeverisje të Hapur, ekzistojnë tri arsye kryesore për hapje të dhënave qeveritare, e që përfshijnë:

- **TRANSPARENCA*** – që qytetarët të dinë se çfarë është duke bërë qeveria e tyre, para së gjithash ata duhet të jenë në gjendje të qasen lirshëm në të dhëna dhe informacione qeveritare, si dhe të shpërndajnë dhe ripërdorin ato.
- **NGRITJA E VLERAVE SHOQËRORE DHE KOMERCIALE** – të dhënat e hapura qeveritare kontribuojnë përmes ofrimit të dhënave/ informacioneve të vlefshme për shoqërinë, si për qëllime sociale ashtu dhe komerciale.
- **PJESËMARRJA DHE ANGAZHIMI** – mundëson për dy palët, shoqërinë dhe qeverinë, performancë më efikase. Shoqëria informohet drejtpërdrejt dhe mund të ndikojnë në vendimmarrje.

* *Transparenca konsiderohet si vullë tradicionale e një qeverie të hapur, që do të thotë se publiku duhet të ketë qasje në informacionin që mban qeveria dhe të informohet për procedurat qeveritare. (Open Source)

Cilave të dhëna po u referohemi?

Datasetet publike që aplikohen dhe përdoren, ose që konsiderohen si reference për shumë palë të interesuara përfshijnë:

- **INFORMACIONE FINANCIARE** – Të dhëna siç janë llogaritë qeveritare (shpenzimet dhe të hyrat) dhe informata në tregjet financiare (aksione, letra me vlerë etj.)
- **INFORMACIONE STATISTIKORE:** Të dhëna të nxjerra nga agjencitë dhe zyret statistikore siç janë censusi dhe indikatorët e tjerë kyç socio-ekonomik.
- **INFORMACIONE BIZNESORE:** Të dhëna mbi regjistra zyrtar të biznesit (përfshirë këtu të dhëna edhe nga Oda Ekonomike).
- **INFORMACIONE SOCIALE:** Lloje të ndryshme statistikash mbi ekonominë, punësimin, shëndetësinë, popullsinë, administratën publike - përfshirë edhe të dhëna dhe modele klimatike si dhe parashikime të motit.
- **INFORMACIONE GJEOGRAFIKE DHE TRANSPORTI:** Të dhëna adresash, fotografi ajrore, ndërtesa, informacioneve kadastrale, rrjetet gjeodezike, gjeologji, të dhëna hidrografike dhe topografike. Po ashtu këtu përfshihen edhe informacione transporti- si informacione mbi bllokimet e trafikut, punishte në rrugë, transporti publik dhe regjistrimi i automjeteve.
- **INFORMACIONE MJEDISI DHE METEOROLOGJIKE:** Të dhëna mbi nivelin e ndotjes, cilësisë së lumenjve dhe tokës. Për më tepër, këtu gjithashtu përfshihen edhe të dhënat meteorologjike

2. Qasja në të dhëna në Kosovë

Në Republikën e Kosovës e drejta për qasjen në dokumentet publike është e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Saktësisht, Neni 41 (E Drejta për Qasje në Dokumente Publike) i Kushtetutës thotë:

“Secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”⁵

Përveç kësaj, Ligji Nr 03 / L-215 mbi Qasjen në Dokumente Publike, që rrjedh nga neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rregullon procedurat që u mundësojnë çdo qytetari kosovar që të kenë qasje të lirë në informatat me karakter publik. Ligji tregon se:

“[...] ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike. Dokumentet janë të hapura për publikun në bazë të kërkesës së drejtpërdrejt, në bazë të kërkesës së bërë me shkrim ose në formë elektronike, me përjashtim të informacioneve të kufizuara me ligj.”⁶

⁵ Constitution of the Republic of Kosovo, <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>
⁶ Law No. 03 / L-215, Public Access to Documents


Vetë ligji obligon një procedurë dhe proces të mundimshëm, i cili pengon qasje në të dhëna nga audiencia e gjerë dhe kufizon shfrytëzimin e të dhënave. Kështu, sipas këtij ligji procesi i aplikimit për qasje në dokumente zyrtare përfshin disa ditë përpunimi të kërkesës.

“Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.”⁷

Për më tepër, ligji mbi qasje në dokumente publike obligon të gjitha institucionet publike të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente. Përkatësisht, nxitur nga ky ligj, u krijua Zyra e Komunikimit Publik (ZKP) në zyrën e Kryeministrit me synim që të bëhet qendër e qasjes në informacion dhe të ofrojë shërbime qeveritare. Të dhënat që ZKP ka mbledhur për Raportin Gjithëpërfshirës për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike nga institucionet publike (Raporti Vjetor, 2014), paraqesin llojet e dokumenteve për të cilat është kërkuar qasja, sub-


⁷ Law No. 03 / L-215, Public Access to Documents

FIG. 1 Lloji I dokumenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në të cilat është kërkuar qasja



Burimi: Zyra për Komunikim me Publikun në Zyrën e Kryeministrit, Raporti Vjetor 2014

FIG. 2 Profili i palëve që kanë parashtruar kërkesa në Qeverinë e Republikës së Kosovës



Burimi: Zyra për Komunikim më Publikun në Zyrën e Kryeministrit, Raporti Vjetor 2014

jektet që kanë kërkuar këto dokumente, si dhe numri i përgjithshëm i kërkesave.

Siç shihet në Figurën 1, në vitin 2014 ndër të dhënat më të kërkuara janë statistikat me rreth 54 për qind, buxheti dhe shpenzimet me 12 për qind, vendimet e lëshuara nga institucionet me afërsisht 9 për qind, dhe pak më shumë se 5 për qind e kërkesave janë bërë për kontrata. Dokumente të tjera të kërkuara prej institucioneve qeveritare janë projekt-ligjet dhe rregulloret me rreth 1 për qind, projekte me 2 për qind, konkurse me rreth 2 për qind, raportet me rreth 2 për qind, informata biznesore vetëm mbi 2 për qind, procesverbale me më pak se 1 për qind, hartë të planifikimit hapësinor me edhe më pak se 1 për qind, si dhe kërkesa të tjera rreth 10 për qind.⁹

Tek kërkesat e pranura në Qeverinë e Republikës së Kosovës, siç shihet në Figurën 2, numri më i madh i aplikuesve iu takon gazetarëve me rreth 45 për qind dhe shoqërisë civile rreth 20 për qind, respektivisht; pasuar nga organizatat buxhetore dhe individët me rreth 9 për qind secili, studentët me afërsisht 7 për qind, kompanitë me rreth 5 për qind, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat me vetëm pak mbi 4 për qind. Dhe në fund, partitë politike dhe deputetët bëjnë më pak se 1 për qind nga kërkesat e përgjithshme.

Numri total i kërkesave për qasje në dokumente publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e tjera vartëse, gjatë vitit 2014 është 851

kërkesa. Nga këto, për 736 kërkesa është lejuar qasja, është refuzuar qasja për 9 kërkesa, për 25 kërkesa është dhënë qasje e kufizuar, 25 të tjera nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje, dhe 56 janë klasifikuar si tjera – ku është kërkuar nga aplikuesi të jap më shumë sqarime lidhur me dokumentin që ka kërkuar, ose kërkesa e tyre është adresuar tek një institucion tjetër. Thënë ndryshe, institucionet si tërësi pranuan vetëm 2.3 kërkesa në ditë – që është një numër mjaft i vogël në krahasim me vlerën që do kishte nëse një platformë e mirë e OGD-së do të funksiononte. Procedurat burokratike dhe vonesat janë arsyet kryesore për situatën në të cilën ndodhet Kosova. Shqipëria si një vend fqinjë që publikon të dhënat e saj publike në portalin e Open Data Albania pranon afërsisht 270 vizitorë të përditshëm të cilët kanë qasje pa pagesë dhe disponueshmëri të të dhënave për përdorimin dhe ripërdorimin e tyre.¹¹

2.1 PQH-ja dhe nisma e saj për të dhëna të hapura

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë e cila filloi në vitin 2011 për të siguruar një platformë ndërkombëtare për akterët vendor të cilët janë zotuar për qeveri më të hapura, llogaridhënese, dhe të përgjegjshëm për qytetarët. Në një përpjekje për të ofruar një qeveri të hapur në vend, nga mesi i vitit 2013, Organizatat e Shoqërisë Civile në bash-

8 <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/ANG-FINAL.pdf>
9 Ibid 8

10 <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/ANG-FINAL.pdf>
11 <http://www.easycounter.com/report/open.data.al>

këpunim me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Integrimeve Evropiane e filluan procesin e anëtarësimit të Kosovës në një nga organizatat më të besueshme për transparencë dhe llogaridhënie, Partneritetin për Qeverisje të Hapur (PQH). Për t'u anëtarësuar në këtë platformë është e domosdoshme që secili vend, në një proces gjithëpërfshirës me akterë të ndryshëm vendorë, të hartojë një Plan Nacional të Veprimit, i cili përmban veprime konkrete, të cilat duhet të implementohen nga institucionet publike. Gjatë fillimit të vitit 2014, akterë të ndryshëm vendorë u takuan për ta përpiluar Planin Nacional të Veprimit 2014- 2016 dhe e dorëzuan në selinë kryesore të PQH-së. Për shkaqe politike Kosova nuk është pranuar të bëhet pjesë e kësaj platforme globale. Pavarësisht kësaj, Qeveria e Repulikës së Kosovës ka nxjerrë një vendim, duke u zotuar ta zbatoj Planin e Veprimit.

Një element kyç i këtij plani të veprimit është ndërtimi i një portali të vetëm shtetëror, ku të dhënat e qeverisë do të jenë në dispozicion. Sipas një raporti të monitorimit të kryer nga Riinvest në vitin 2014, ky plan është neglizhuar plotësisht nga qeveria. Ironikisht, buxheti i ri i alokuar për pajisje dhe shërbime të TI-së në institucionet publike ka rënë, duke u bërë sa 1/9 e shumës së mëparshme. Për më tepër, nuk ka dokumente strategjike dhe as politika të tjera që synojnë zhvillimin e të dhënave të hapura qeveritare dhe krijimi i një kuadri bazë të menaxhimit institucional të asaj fushe.

2.2 Organizata 'Open Data Kosovo'

Organizata 'Open Data Kosovo' është krijuar me qëllim për të hapur të dhënat të cilat janë të disponueshme në Kosovë, e cila ishte ide e një ndërkombëtarë të angazhuar në Kosovë, kështu duke sjell përvojën e tij si inxhinier i softuerit. ODK është organizatë që kryesisht kontribuon në zhvillimin lokal dhe teknologjik. Laboratori i Organizatës 'ODK' ofron trajnime dhe angazhon zhvilluesit lokal të softuerit për të përmirësuar platformën e ODK-së dhe ndërtuar aplikacione me anë të të dhënave të hapura të Kosovës në të mirën e shoqërisë. Prandaj, kjo organizatë synon krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvilluesit e aplikacioneve për të ndërtuar aplikacione bazuar me të dhënat e hapura të ofruara nga institucionet qe-

veritare- aplikacione që do të jenë interaktive dhe zbavitëse për qytetarët.

Aktualisht, ODK hap të dhënat e mbledhura nga një numër i kufizuar i institucioneve, e që përbëjnë 12 institucione në total; si qeveritare ashtu edhe jo-qeveritare (siç janë: 5 komuna, 3 ministri dhe 4 OJQ). Përveç kësaj, ajo gjithashtu avokon për të dhëna të hapura në të gjitha nivelet. ODK sheh si përparësi të saj zotërimin dhe mundësimin e teknologjive të reja, aftësinë për zhvillim të shpejtë të aplikacioneve me metodologji agjile (zhvillim i shpejtë i softuerit) dhe krijim të shpejtë të prototipit, dhe marrëdhëniet e mira me akterët kyç të teknologjisë dhe OJQ-ët rajonale për transparencë. Sidoqoftë, ODK-ja akoma has në vështirësi për të bindur zyrtarët e qeverisë mbi konceptet e të dhënave të hapura, gjë që shpesh kërkon kohë derisa akterët e përfshirë në politikë të ndihen komod për të bërë hapjen e të dhënave.¹²

Sipas Z. Imeri nga ODK¹³, Qeveria ka bërë disa përpjekje mbi parimet dhe veprimet e Partneritetit për Qeveri të Hapur, dhe ka treguar interes për të bashkëpunuar me Open Data Kosovo. Mirëpo sa i përket funksionit të ODK drejt përmbushjes së qëllimeve të OGP, Z. Imeri thotë se Open Data Kosovo mund të shërbejë kryesisht rreth mentorimit dhe këshillimit të akterëve politikë, duke siguruar mbështetje teknike si në trajnime ashtu edhe në krijimin e platformës dhe infrastrukturës digjitale, në avokim, hartim të politikave, dhe gazetari hulumtuese.

Për fund, Open Data Kosovo në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit Evropian dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit janë duke punuar në drejtim të krijimit të një moduli të integruar ku qeveria mund të publikojnë të gjitha të dhënat e klasifikuara. Emri i domenit për këtë modul është 'Portali i të dhënave të hapura'¹⁴, i cili tashmë ka tetë datasete nga tetë organizata të ndryshme. Megjithatë, nuk ka informacion se si do të funksionojnë ky modul dhe cilat do të jenë rezultatet.

12 P. Imeri, Director of Engineering, Open Data Kosovo, personal communication, July 3, 2015

13 Ibid 15

14 <http://data.rks-gov.net/>

3. 'Bëj të dhënat të flasin shqip' – Open Data Albania

Ekzistojnë disa modele të përdorura nga shtete dhe organizata të shoqërisë civile të ndryshme që i përdorin për të ndërtuar uebfaqe të dhënave të hapura qeveritare. Këto modele përfshijnë, ndër të tjera, uebfaqen e Shteteve të Bashkuara - www.data.gov, dhe uebfaqen e Mbretërisë së Bashkuar www.gov.uk. Të dy faqet aktualisht mbajnë mijëra publikime dhe datasete që mund të kërkohen në bazë të temës. Faqet e lartpërmendura përveç promovimit të transparencës dhe llogaridhënies me praninë e tyre në internet, ato inkurajojnë përdorimin inovativ të dhënave dhe teknologjisë. Instituti Shqiptar i Shkencave ka prezantuar një zgjidhje të ngjashme në Republikën e Shqipërisë, duke ndërtuar platformën dhe hapur të dhënat qeveritare.

Sipas Aranita Brahaj¹⁵ nga Instituti Shqiptar i Shkencave, Open Data është filozofia që mbështet përdorimin dhe rishpërndarjen e të dhënave pa kurrfarë kufizimi. Instituti ka iniciuar projektin Open Data Albania (ODA) për të promovuar kryesisht parimet e të Dhënave të Hapura. Kështu, duke nxjerrë të gjitha të dhënat mbi indikatorët socio-ekonomike në dispozicion nga institucionet publike, pastaj konvertimin dhe publikimin e këtyre të dhënave bazuar në teknologjitë më të fundit të informacionit.¹⁶

Open Data Albania (ODA) shërben si arkiva qendrore për të gjitha të dhënat e qeverisë, e cila lehtëson kërkimin dhe ripërdorimin e të dhënave publike. Vizualizimi i qartë dhe përshkruar i të dhënave dhe përgatitja e artikujve është qëllimi kryesor i këtij projekti. Open Data Albania (ODA) www.open.data.al ka filluar të implementohet fillimisht në zyrat e Institutit Shqiptar të Shkencës, duke përdorur stafin dhe buxhetin e këtij Instituti për nevojat e projektit. Mbledhja e të dhënave qeveritare nga ODA është bërë dhe bëhet në mënyrë graduale; si dhe Open Data Albania hapë vetëm të dhëna dhe informacione zyrtare. Planifikimi i hapjes së të dhënave përcjellët me kërkesë të veçantë në institucionet përkatëse qeveritare. Përzgjedhja e grupeve të të dhënave është proces i cili siguron se ato të dhëna përmbushin të gjitha parimet e të dhënave të hapura dhe iu përmbahen metodologjisë së caktuar.

Platforma Open Data Albania është shumë e njohur në mesin e gazetarëve, dhe sipas Aranita Brahaj media është partner kyç i platformës së të dhënave të hapura, të cilët vazhdimisht përdorin të dhëna nga ODA për t'i ofruar publikut informacion në aspekte të ndryshme social-ekonomike.

15 A. Brahaj, the Executive Director of the Albanian Institute of Science

16 <http://ais.al/new/>

4. Përmbledhje dhe Rekomandime

Fusha e të Dhënave për Qeveri të Hapur (OGD) është ende një potencial i pashfrytëzuar i cili mund të përhapet shpejt nëse të dhënat publike bëhen të hapura. Kjo ndodhë vetëm në qoftë se të dhënat mund të përdoren pa pagesë, janë të lexueshme nga makina, dhe nuk kanë asnjë kufizim (si: ligjorë, financiarë, apo teknologjik) në qasje dhe ri-përdorimin të tyre nga të tjerët. Megjithatë shumë vende në botë kanë përqafuar nismën e Open Data, situata në Kosovë nuk është duke kontribuar në mënyrë efikase për një mjedis më të mirë të të dhënave të hapura.

Ligjet mbi të drejtën e qasjes në dokumente publike në Republikën e Kosovës nuk japin udhëzime të përcaktuara saktë se si të bëhet hapja proaktive e të dhënave, rrjedhimisht kjo pengon në zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Korniza ligjore për prezencën në internet, e veçanërisht për informacionet e detyrueshme është mjaft e fragmentuar. E gjithë kjo tregon një nivel të ulët të zhvillimit të pranisë në ueb dhe transparencë të mangët të institucioneve publike në Kosovë.

Prandaj, është e rëndësishme të bëhen ndryshime në ligjin për qasje në dokumente publike dhe të rritet prania e institucioneve publike në internet, pasi që kjo mund të ngritë vetëdijen e qytetarëve mbi rëndësinë e disponueshmërisë dhe qasjes së informacionit në faqet zyrtare të institucioneve. Rrjedhimisht, kjo gjithashtu kontribuon në numrin e dokumenteve publike të kërkuara në Qeverinë e Republikës së Kosovës, i cili për vitin 2014 ishte rreth 851 kërkesa në total. Numri i lartë i kërkesave në dokumente publike do të thotë pjesëmarrje më e lartë si dhe angazhim dhe ndikim më të madh të shoqërisë në proceset vendim-marrëse. Kosova gjithashtu mund të hartojë një ligj të bazuar mbi parimet e OGD-së i cili rregullon çdo gjë në lidhje me OGD-në.

Është më se e nevojshme të ndryshohen dokumentet ekzistuese në fushën e zhvillimit dhe mirëmbajtës së faqeve zyrtare të institucioneve publike në përputhje me trendet dhe praktikat botërore, dhe të miratohen dokumentet në bazë të institucioneve përkatëse. Më saktësisht, është me rëndësi që versionet e reja të këtyre dokumenteve të përcaktojnë përmbajtjen në mënyrë të saktë, dhe llojin e informacionit që institucionet publike duhet të hapin rregullisht.

Platforma në të cilën publikohen të dhënat, siç është platforma e nisur së fundmi në Kosovë 'http://data.rks-gov.net', mund të rezultojë në një shoqëri më të informuar dhe qeveri shumë më transparente. Për më tepër, të dhënat e publikuara duhet të jenë në përputhje me parimet e Open Data që mundësojnë ripërdorimin e tyre duke hapur të dhënat në formatet e duhura.

Për fund, duke pasur parasysh se OGD është një koncept relativisht i ri, është më se e nevojshme që të sigurohen trajnime të vazhdueshme të punonjësve të institucioneve publike, veçanërisht për punonjësit e ngarkuar me menaxhimin e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjeve të faqeve zyrtare. Në këtë mënyrë portali shtetëror do promovonte trendet moderne të një qeverie të hapur, transparente dhe llogaridhënëse.

Bibliografia

1. Instituti i Shkencave të Shqipërisë (AIS), 2015, Rastet e përdorimit të Open Data Albania, e nxjerr nga: <http://ais.al/new/publications/>
2. Instituti Riinvest, 2015, Raporti i Monitorimit, Plani Nacional i Veprimit 2014-2016. e nxjerr nga: http://riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Raporti_i_Monitorimit1419261410.pdf
3. KFOS, 2015, Open Data Workshop, Durrës
4. H. Julia, B. Armend, 2015, Open Government Data on the Web: A Semantic Approach
5. Open Data Kosovo, 2015, Misioni i Open Data Kosovo, e nxjerr nga: <http://opendatakosovo.org/open-data-kosovo-mission/>
6. USAID, 2013, Doracak për Qasje në Dokumente Publike, e nxjerr nga: <https://kk.rks-gov.net/novoberde/getattachment/2b762872-f1ad-466b-9db8-1c50b8bddbba/Doracak-per-qasje-ne-dozrtare.aspx>
7. Zyra e Komunikimit me Publikun, 2014, Raporti Vjetor 2014, e nxjerr nga: <http://kryeministri-ks.net/repository/docs/ANG-FINAL.pdf>
8. Ubaldi, B. (2013), Open Government Data: Towards Empirical Analysis of Open Government Data Initiatives, OECD Working Papers on Public Governance, No. 22, OECD Publishing, e nxjerr nga: http://www.opendataforum.info/files/OECD_Barbara_Ubaldi.pdf
9. Republika e Kosovës, Zyra e kryeministrit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e nxjerr nga: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>
10. Asambleja, Republika e Kosovës, Ligji Nr. 03 / L-215, Qasja në Dokumente Publike, e nxjerr nga: <http://www.right2info.org/resources/publications/KosovoLawonAccesstoPublicDocuments.pdf>
11. Open Knowledge Foundation, Open Government Data, e nxjerr nga: <http://opengovernmentdata.org/#sthash.q3iFN8iA.dpuf>
12. Open Source, Discover an Open Source World, e nxjerr nga: <http://opensource.com/resources/open-government>
13. Data. Gov, 2013, Open Data, A history e nxjerr nga: <https://www.data.gov/blog/open-data-history>
14. The White House, 2010, Transparency and Open Government, e nxjerr nga: https://www.whitehouse.gov/the_press_office/TransparencyandOpenGovernment
15. Republika e Kosovës, Qeveria, Udhëzim Administrativ Nr. 02/2011 për portalin qeveritar të Republikës së Kosovës, http://testmap.rks-gov.net/userfiles/file/document_page/Udhezimi_Administrativ_Nr_02_2011_Per_Portalin_Qeveritar_te_Republikes_se_Kosoves.an.pdf
16. Gov. UK, 2015, Publications, e nxjerr nga: <https://www.gov.uk/government/publications>
17. Data. Gov, 2015, Data Catalog, e nxjerr nga <http://catalog.data.gov/dataset>
18. Easy Counter, 2015, Visit open.data.al, e nxjerr nga: <http://www.easycounter.com/report/open.data.al>
19. Republika e Kosovës, Portali i të Dhënave të Hapura, e nxjerr nga: <http://data.rks-gov.net/>

Ky publikim është rezultat i projektit Avokimi për Qeverisje të Hapur, i cili po zbatohet në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni, Serbi dhe Kosovë.



E drejta autoriale © 2015 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

Ky publikim është i financuar nga Bashkimi Evropian



Publikuar nga:
INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org